



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 3343/3 Prot.

Vlorë më, 23.12.2025

VENDIM

Nr. 130, datë 23.12.2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E "PËRDORIMIN TË ITHENTICATE, SOFTËARE-IT PËR DETEKTIMIN E PLAGJIATURËS NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE BOTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË, MIRATUAR ME VENDIM TË SENATIT AKADEMIK NR.24, DATË 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali"; VKM-së nr. 777, datë 26.12.2018, e ndryshuar me VKM-në nr. 99, datë 05.02.2020 "*Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore*"; Vendimit nr. 62, datë 11.02.2020 të Senatit Akademik të UV-së "*Për kriteret dhe standardet për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve*", Vlorë si dhe referuar propozimit të Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të tretët, ardhur me shkresën datë 3230 Prot., datë 12.12.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 6 të Rregullores për "*Përdorimin e iThenticate, software-it për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë*"; si më poshtë:

Përdorimi i programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës në kuadër të veprimtarisë akademike të Senatit Akademik dhe këshillave shkencorë dhe botues

• *Ishte:*

1. Këshillat shkencorë dhe botues i dërgojnë Kryetarit të Senatit në formë elektronike punimin/et shkencor/ë, publikimin/et, temën/at apo çdo dorëshkrim tjetër që ka marrë miratimin nga Senati Akademik për t'iu nënshtruar kontrollit përmes përdorimit të programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

2. Personat e autorizuar, me vendim të Rektorit, realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës dhe raportin ia dorëzojnë rektorit, i cili ia dërgon Senatit Akademik. Rezultatet e kontrollit i përcillen këshillave shkencorë dhe botues ose palës së tretë të interesuar.

• *Bëhet:*

1. Drejtuesit e njësive bazë, redaktorët ekzekutivë të revistave shkencore dhe botimeve UniVlora, apo persona të tjerë të autorizuar i përcjellin Rektorit të Universitetit 'Ismail Qemali', në formë elektronike, materialet origjinale për botim / punimet shkencore / artikujt shkencorë / disertacionet / temat e diplomave dhe çdo produkt tjetër në pronësi intelektuale të UV-së, për t'iu nënshtruar kontrollit të origjinalitetit përmes përdorimit të programeve kompiuterike për detektimin e plagjiaturës. Zëvendësrektori për Marrdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor verifikon pronësinë e UV-së mbi këto materiale.
 2. Të drejtën për të kryer kontroll antiplagjiaturë në programet kompiuterike të përdorura nga UV e kanë edhe punime që nuk janë pronësi intelektuale e UV-së, sipas kërkesës në Rektorat nga palë të treta apo personel i Universitetit të Vlorës. Në këtë rast shërbimi ofrohet me pagesë, sipas tarifave të miratuara në BA.
 3. Rektori përcjell materialet për kryerjen e kontrollit antiplagjiaturë tek personat e autorizuar me vendim të Rektorit, të cilët realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga data e pranimit të kërkesës dhe raportin e kontrollit ia dorëzojnë Rektorit. Rezultatet e kontrollit iu përcillen strukturave apo palëve të interesuara.
2. Ky ndryshim ka për qëllim qartësimin dhe përditësimin e procedurave të verifikimit dhe miratimit institucional.
 3. Ky Vendimi i bëhet me dije Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të tretët, Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike me qëllim publikimin në faqen e UV-së; si dhe çdo Nësie Kryesore

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

AS

